



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbal i dëgjimit publik për Buxhetin 2023 – fshati Sfeçël

Dëgjimin publik e hapi drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve.

Drejtori Osmani theksoi që Komuna e Podujevës ka filluar me dëgjimet publike të buxhetit për vitin 2023, e që dëgjimi i parë po realizohet në fshatin Sfeçël dhe me banorët e fshatrave përreth.

Dëgjimi është organizuar me qëllim të marrjes së kërkesave të banorëve të këtyre lokaliteve.

Komuna e Podujevës për vitin 2022 ka patur një buxhet prej 23.449.520 Euro, ndërsa në bazë të parashikimeve të Qarkores Buxhetore për vitin 2023 ka një rritje të buxhetit, që do të jetë 27.406.566 euro me ndonjë të lëvizje të vogël nga Qarkorja e dytë buxhetore, por gjithsesi do të ketë rritje prej afér 4 mil euro të buxhetit.

Meqenëse jemi në një fshat ku mirret shumë me bujqësi është shumë e rëndësishmë që kemi rritje të subvencioneve në bujqësi, ku nga 460 mijë euro në vitin e ardhshëm do të janë mbi 700 mijë euro subvencione në bujqësi, një rritje të ndjeshme ku do të përfitojnë bujquit. Rritje do të ketë edhe në fushën e Arsimit, Kulturës dhe të Zhvillimit Ekonomik. Gjithesi ne kemi identifikuar edhe kërkesat e çdo fshati dhe do të ketë investime në cdo vend në cdo lokalitet tha drejtori Osmani.

Drejtori i shërbimeve Publike, Bahri Selimi gjithashtu falënderoi të pranishmit duke u deklaruar i hapur për cdo kërkesë të banorëve.

Banor i fshatit Sfeçël – “Kanë mbet shumë rrugica pa u asfaltuar, por problemi i kemi edhe me lumen që vjen nga Dumnica, rrezikohemi nga gjarpërit, pjesa e lumit nga shkolla, ka shumë shpesh vërvshime me dëme të mëdha, pastaj kemi nevojë për një urë e cila na shërben për nevoja të fshatit në at pjesë”.

Banor i fshatit Sfeçël – “Ne në fshat kemi nevojë për intervenimin në disa rrugica nga viti 2015 mirëpo asnjëherë sjanë përfundu, ju kisha lut me dal në teren me pa gjendjen e këtyre rrugicave, dhe pyetja jem per juve është a ka ndonjë plan komuna e Podujevës me rregullu sheshin “Ali Ajeti”.

Drejtori jemi në fazën e studimit të vizibilitetit ku është duke u planifikuar një parking nëntokësor dhe sigurisht pjesa e sipërme do të rregullohet si shesh, por është procedur pothuajse e gjatë për shkak të madhësisë së projektit.

Drejtor i shkollës “Ali Ajeti”, “Kërkesa jonë është fillimisht që objektin e shkollës së vjetër është monument afér 90 vjecar, nësë keni mundësi ta rinovoni do të ishte shumë e mirëseardhur, pastaj si shkollë nuk kemi laboratore të kimisë, biologjisë dhe kimisë, dhe klasët tjera për TIK dhe bibliotekë. Pastaj kemi një numër të madh të nxënësve afér 600, por skemi sallë të mbyllur të edukatës fizike, ndërsa afér shkollës veturnat po qarkullojnë shumë nësë ka mundësi 4 pengesa për shkak të sigurisë së nxënëseve” tha drejtori Lulzim Ajvazi.

Arjant Topanica – asamblist nga radhët e LDK-së nga fshati Sfeçël, “Skisha dashtë me i përsërit kërkesat e banorëve të mi, por kisha dashtë me ngrit cështje tjera, ndriçimi publik shumë shpejtë po dëmtohet qoftë në seri qoftë një nga një, dmth me rregullu këtë problem edhe me i vazhdu pjesët tjera të cilat nuk kanë ndriçim, pastaj ndërtimi i trotuareve ka filluar por kish me qene mirë me përfshi sa më shumë km, ndërsa urën te Mehanët dhe Topanicët është vec në fazën finale, dhe gjithashtu te rrugicat i kisha specifiku sepse është shumë e nevojshme, të mahalla e Zeqirëve, te Govorët, te Lagjia e Vokrrollëve”.

Drejtori Selimi përgjigjet në pyetjet e banorëve, flet për gjendjen e fazës së projekteve ku thekson se komuna ka ndarë një buxhet për vitin që vjen, ne fillimisht kemi me i trajtu pjesët që shkaktojnë më shumë rrezik sikurse rasti që e përmendet më parë, duke shpresuar që kemi me arrit deri te pjesa e Sibocit, ndërsa në vitin e ardhshëm pritet të vazhdojmë tutje, një urë vec jemi në përfundim në fshatin e juaj, ndërsa sa i përket trotuareve kemi filluar një pjesë koxha të madhe dhe do të vazhdojmë edhe vitin e ardhshëm, si prioritet i shohim rrugët prioritare kur janë nxënësit dmth afér shkollave, ndërsa sa i përket ndriçimit publik ju e dini që në Sfeçël kemi bërë një mbulushmëri koxha të madhe me ndriçim, këtë vit kemi punu edhe rrugën e juaj tani që lidhet me Dumoshin, ndërsa dëmtimet janë për shkak të kushteve atmosferike që ka patur gjatë këtij viti, mirëpo ne jemi tani në identifikimin e këtyre problemve dhe do t'i trajtojmë, dhe rrugët dhe rrugicat janë planifikuar në kuadër të drejtorisë së Planifikimit Urban.

Drejtori Osmani, rikthekson se një pjesë e rrugëve do të kryhen në 2022 por një pjesë tjeter mbeten edhe për vitin e ardhshëm 2023, sic e theksova më parë për rritjen e buxhetit për vitin e ardhshëm kjo do të na mundësojë edhe investimet në rinovimet në shkollën Sfeçël ku është e parapame që ky objekt të kthehet në qerdhe që mund tu shërbej fshatit Sfeçël dhe fshatarve përreth për shkak të numrit të madh të fëmijëve, ndërsa lidhur me ndërtimin e sallën e edukatës fizike figuron në investimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, por problematikat e fundit të cmimeve e prolenguan mirëpo ne jemi në kontakt me MKRS në mënyrë që të realizohet ky projekt.



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Debati publik lista e nënshkrimeve për Buxhetin e vitit 2023

Lista e pjesëmarrësve

